

05.01.2024

Ora, 10:32

**RENDI I DITËS**

**“Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 95/1, depozituar nga subjekti zgjedhor  
“Partia e Lirisë”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali,  
z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** S’ka
- **Të tjerë:** Z. Lefter Maliqi
- **Avokatë:** Z. Th. Sollaku, z. A. Llangozi, z. F. Nuri

**Z. E. Lako:** Mirë, deklarojmë të çelur seancën e sotme për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore nr. 95/1, depozituar në datën 24.11.2023, nga subjekti Partia e Lirisë, me objekt: Ankim kundër vendimit të KQZ-së për rrëzimin e kërkesës së Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për të shpallur të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të kryetarit të Bashkisë Kuçovë zotit Kreshnik Hajdari. Ky vendim t’i njoftohet menjëherë Kryeministrit për të vijuar me procedurat e parashikuara në nenin 115 të Kushtetutës. Në lidhje me shqyrtimin e projektvendimit “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues zotit Kreshnik Hajdari, kryetar i Bashkisë Kuçovë, Qarku Berat, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, datë 14 Nëntor 2023, ora 12:00 nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

Seanca paraprake për verifikimin e plotësimit të elementëve të formës dhe përmbajtjes për këtë kërkesë ankimore, u zhvillua më datë 18.12.2023, në prani të trupës së plotë të KAS, Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ, administrata dhe palëve prezentë, avokat zoti Theodhori Sollaku i cili mbron interesat e zotit Kreshnik Hajdari në këtë procedurë administrative. Avokat zoti Arben Llangozi, në cilësinë e përfaqësuesit të subjektit “Partia e Lirisë” dhe avokat zoti Franci Nuri, në cilësinë e përfaqësuesit të subjektit “Partia Demokratike e Shqipërisë”. Në mbledhjen e datës 18.12.2023, pas relatimit të çështjes objekt shqyrtimi, u konstatua se kërkesa ankimore regjistruar me nr. 95/1, depozituar nga subjekti zgjedhor “Partia e Lirisë”, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementët e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, kërkesa ankimore kaloi për shqyrtim, duke u caktuar si datë, data e sotme 05.01.2024, ora 10:30. Palët kanë marrë dijeni për këtë seancë gjatë seancës paraprake dhe janë njoftuar edhe elektronikisht nga administrata e KQZ. Me sa shoh, janë prezent këtu në këtë seancë, kështu që vazhdojmë me shqyrtimin në themel të çështjes. Relator i kësaj çështje, sipas shortit të hedhur, jam zgjedhur unë Elvin Lako. Palë të interesuara të tjera, ndonjë kërkesë tjetër të bërë në administratën e KQZ-së nuk ka. Ka ndonjë kërkesë tjetër?

**Z. F. Nuri, avokat (P L):** Faleminderit zoti relator, thjesht autorizimin nga Partia e Lirisë për mua, që të jem përfaqësues i tyre, bashkë me zotën Llangozi. Do të jem dhe unë së bashku me zotën Llangozi, pra avokat Franci Nuri bashkë me avokatin zotën Arben Llangozi, do të jemi të dy përfaqësues të subjektit Partia e Lirisë, për të ndjekur këtë çështje sot, përpara trupës së KAS-it, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

**Z. E. Lako:** Mirë, faleminderit! Ka ndonjë kërkesë paraprake, u bëjmë pyetje palëve, në lidhje me përjashtimin e anëtarit të KAS-it, apo ndonjë mungesë kompetence, apo ndonjë afat? Ka ndonjë kërkesë paraprake?

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Jo nuk kemi!

**Z. E. Lako:** Mirë, faleminderit zoti Llangozi!


**Z. Th. Sollaku, avokat (z. K. Hajdari):** Jo nuk kemi!

**Z. E. Lako:** Mirë, faleminderit zoti Sollaku!

Nuk kemi kërkesa paraprake, vazhdojmë me shqyrtimin e themelit të çështjes. Shkurtimisht zoti Sekretar i Përgjithshëm, na bëni një përshkrim të shkurtër në lidhje me këtë çështje.

**Z. Y. Merkaç:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë në shqyrtim rezultatet e verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Kreshnik Hajdari, kryetar i Bashkisë Kuçovë i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Pas shqyrtimit administrativ, me datën 14.11.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur me vendimin nr. 816 që Kreshnik Hajdari nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të kryetarit të Bashkisë Kuçovë. Duke mos qenë dakord me këtë vendim të KSHZ, pala ankuese Partia e Lirisë, ka bërë ankim ku pretendon se vendimi i KSHZ nuk është në përputhje me ligjin 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

**Z. E. Lako:** Mirë, falemiderit zoti Merkaj! I japim fjalën palës ankuese, kush dëshiron nga të dy përfaqësuesit e subjektit zgjedhor Partia e Lirisë!

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Po të nderuar, jemi këtu ku kemi kërkuar shfuqizimin e vendimit të marrë nga Komisioneri, si përfaqësues i KQZ, i cili ka vendosur rrezimin e kërkesës së Koalicionit “Bashkë Fitojmë” për të shpallur të pavlefshëm formularin e vetëdeklarimit. I jemi drejtuar këtij kolegji në bazë të ligjit, ku kërkojmë “shfuqizimin e këtij vendimi”, si një vendim i padrejtë qoftë në ligj, por edhe si vendim i marrë në mënyrë fiktive nga ana e Komisionerit. Pra, Komisioneri në vendimmarrjen e tij, jo vetëm që nuk është bazuar në ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe në rregulloret e saj, por ai ka devijuar edhe faktin duke marrë për bazë disa raste të tjera në vendimmarrjen e tij, të cilat nuk kanë lidhje fare me ngjarjen, ose me faktin që ne jemi duke gjykuar. Zoti Celibashi në vendimmarrjen e tij është bazuar., ka argumentuar se kemi të bëjmë me vendimin e datës 1.11.2019. pra, ky vendim nuk është arsyetuar në asnjë pikë. Ne e kemi ngritur si pretendim dhe nuk është bazuar në asnjë pikë ky shtetas. Njëkohësisht zoti Celibashi ka marrë rolin e ligjvënësit në Republikën e Shqipërisë. Komisioneri ka interpretuar ligjin duke thënë se “sipas ligjit nuk është i detyruar që të deklarojë në formularin e vetëdeklarimit, shtetasi Kreshnik Hajdari, apo cilido shtetas tjetër, vepra penale të cilat nuk është i detyruar”. Ky është një interpretim i cili bie jo vetëm në kundërshtim me vetë ligjin, por bie në kundërshtim edhe me vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me numër 17/2016. Me qëllim, Komisioneri ka arsyetuar se nuk jemi në rastet e ndalimit për kandidim të shtetasit Kreshnik Hajdari. Ne, nuk kemi kërkuar ndalimin për kandidim të tij, por ndalimin për moszgjedhshmërinë e tij në këtë funksion, për arsye se ky shtetas nuk ka plotësuar në mënyrë korrekte formularin e dekriminalizimit, që është një detyrim ligjor për të bërë këtë gjë. Në qoftë se ne i

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

referohemi vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në nenin 10 të tij është detyrim ligjor i cilido organi të konstatojë pavlefshmërinë e zgjedhjes së këtij kandidati. Pra, nëse ne i referohemi pikës “d” të kësaj dispozite, pra vendimit nr. 17/2016, neni 10, pika “d”, është përcaktuar në mënyrë të qartë që KAS, apo KQZ shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit, kur kushtet e mosdeklarimit, apo moszgjedhshmërisë.., pra kemi dy raste moskandidim dhe moszgjedhshmërinë. Pra, me qëllim, zoti Celibashi bën interpretime ligjore të cilat nuk kanë lidhje me faktin aktual. Në analogji dhe kjo është e tmerrshme ta mendosh se në një shtet demokratik të mos zbatohet ligji, ashtu si zoti Celibashi ka vepruar. Ne po e marrim të mirëqenë, pavarësisht njohurive të tij ligjore, sepse zoti Celibashi ka pasur statusin magjistrat, ka qenë në funksione të larta në lidhje me drejtësinë shqiptare. Pavarësisht këtij fakti, ne i kemi bërë me dije se Gjykata e Lartë, Kolegji i Gjykatës së Lartë, ka nxjerrë dhe një vendim që është vendimi nr. 215, datë 24.07.2023 ku ka konstatuar në mënyrë të qartë se si veprohet në raste të tilla. Po j’ua citoj shkurtimisht se çfarë thotë ky vendim. Ai konstaton se “referuar përmbajtjes së formularit të vetëdeklarimit, i dalë në zbatim të Ligjit 138/2015, miratuar me vendimin 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, subjektet deklaruese që përcaktohen në këtë ligj, kanë detyrimin të pasqyrojnë në formular çdo vendim penal të formës së prerë, të dhënë nga një autoritet gjyqësor shqiptar, apo i huaj, pavarësisht llojit të veprës penale, llojit të masës së dënimit..”. Madje në rubrikën për marrje dijëni të efekteve të formularit të vetëdeklarimit në pikën “b” të saj parashikohet se “pasqyrimi i të dhënave të rreme në këtë formular, përbën vepër penale”. Ky është vendimi i një kolegji të vitit 2023, i muajit gusht. Ky vendim i një kolegji të një gjykate, të një sistemi drejtësie, i cili është jo vetëm i pavarur, por është një drejtësi e re e rekomanduar nga ndërkombëtarët, ka dalë në konkluzionin se: cilido kryetar bashkie duhet të deklarojë në formularin e


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

vetëdeklarimit çfarëdo lloj vendimi. Ajo që është më e çuditshme është se zoti Celibashi, i referohet praktikës së tij dhe nuk merr për bazë vendimet e gjykatës, të formës së prerë që është vendimi i Gjykatës së Lartë. Nëse ne i referohemi nenit 450 dhe vijues të Kodit të Procedurës Penale, vendimet e gjykatave janë të detyrueshme të zbatohen, qoftë për zotin Celibashi dhe nuk mund të dalë zoti Celibashi dhe të marrë një vendim në kundërshtim flagrant me vendimin e Kolegjit të Gjykatës së Lartë. Këtë vendim ne e kemi edhe ditën e sotme, në cilësinë e provës do t'jua vemë në dispozicion. Rasti konkret ka qenë një rast analog është një vendimmarrje që ka të bëjë për të njëjtin fakt penal pothuajse, për një kundravajtje administrative dhe në përfundim ka rezultuar se kemi të bëjmë me një paligjshmëri të kryer nga ky funksionar publik. Vendimin kërkoj ta vë në dispozicion në cilësinë e orientimit, por dhe në cilësinë e provës, pavarësisht se këto janë dhe publike. Unë e kam marrë me vullë të njehsuar, na rezulton se zoti Kreshnik Hajdari nuk e ka plotësuar drejt formularin e vetëdeklarimit. Ai nuk ka deklaruar një dënim në shtetin grek. Mund të thotë dikush që ky është një dënim i hershëm dhe të gjithë mund ta kenë kryer. Nuk jemi këtu për të gjykuar veprimet apo mosveprimet, se çfarë ka kryer zoti Hajdari në atë kohë, por veprimet dhe mosveprimet të kryera në formularin e vetëdeklarimit që përbën një vepër penale. Kjo vepër penale dënohet nga Kodi Penal. Nuk është se e ka bërë një herë, por e ka bërë dy herë. Ajo që është më e çuditshme është se zoti Hajdari, nga raporti i sjellë nga Prokuroria e Përgjithshme nuk është se duhet të konstatohet pavlefshmëria e formularit vetëm për faktin që ka kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme, por në vitin 2017, ai është depërtuar nga shteti grek. Kjo është e provuar me shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme. Përfundimisht, këto janë pak a shumë. Duhet të konstatohet pavlefshmëria se ky është një precedent i rrezikshëm, jo vetëm për këtë rast, por duhet të jetë mësim që të gjithë kandidatët që kandidojnë duhet të deklarojnë dënimet. Mund të mos jetë ndalim për të kandiduar, por ndalim

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

për të mos u zgjedhur në bazë të vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, sepse ka gënjyer në formularin e vetëdeklarimit. Paraqitja e rrethanave të rreme, sjell pavlefshmërinë e formularit dhe pavlefshmëria normalisht, sikur ai të mos kishte aplikuar kurrë pranë këtij institucioni, se ka sjellë rrethana të rreme. Për këtë arsye ne kërkojmë: shfuqizimin e vendimit dhe pranimin e kërkesës sipas objektit të saj.

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Llangozi! Po zoti Nuri!

**Z. F. Nuri, avokat (P L):** Doja të bëja një përmbledhje në formë plotësimi të parashtrimeve tona. Pse jemi këtu para KAS-it? Zoti Kreshnik Hajdari rezulton se ka fshehur dënimin e tij nga gjykata greke, vendim i formës së prerë. Madje sipas informacioneve nga media, rezulton se është paraqitur dhe në SPAK për këtë çështje. Për çështjen e mosdeklarimit të saktë të formularëve. Pra, veprën penale të falsifikimit të dokumentave dhe formularëve. Pak rëndësi ka masa e dënimit dhe lloji i tij që zotëria rezulton sipas vendimit grek që mund të ketë marrë në atë kohë. Këtë ne e kemi theksuar dhe në seancën para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, zotit Celibashi. Nuk do t'i hyjmë fare thelbit që ka qenë dënim me gjobë, apo ka qenë dënim me burg, apo diçka e ngjashme. Pak rëndësi ka kjo për ne. Ajo që ka rëndësi për ligjin e dekriminalizimit është nëse vendimi ka qenë i formës së prerë, apo jo? Nëse dënimi rezulton i deklaruar apo jo? Rëndësi ka që subjekti që kishte detyrimin ta deklaronte nuk e ka deklaruar vendimin gjyqësor të formës së prerë, për më tepër të një vendimi të një gjykate të huaj. Ne si koalicion "Bashkë Fitojmë" e kemi paraqitur këtë pretendim që në krye të herës, edhe para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve zotit Celibashi, por që pretendimet tona nuk u muarën për bazë. Ne do t'i shpjegojmë shkurtimisht dhe arsyet. Atëherë, Partia e Lirisë si pjesë përbërëse dhe drejtuese e Koalicionit "Bashkë Fitojmë", nga pikëpamja juridike ka ardhur

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

përpara KAS-it për të vijuar ankesat. Zoti Celibashi ka kryer zbatim të gabuar të ligjit dhe vendimit të Kuvendit në vlerësimin dhe gjykimin tonë. Çfarë thotë ligji? Për ta bërë të thjeshtë dhe për publikun ndoshta që po na ndjek. Nëse nuk e deklaroi në formular që ke qenë i dënuar, atëherë kjo përbën veprë penale që është një aspekt tjetër, por të ndërpritet dhe mandati. Kështu është ndjekur si praktikë dhe nga KQZ-ja për raste të ngjashme identike do të thoja me zotin Hajdari. Praktikë që ka ndjekur institucioni i KQZ-së, në 1 nëntor mos gaboj, të 2019 me rastin e Agim Kajmakut. Ne jemi këtu për të krijuar dhe vijimësinë e institucionit, parimin kushtetues të vijimësisë së institucioneve. Zoti Celibashi u justifikua në vendimmarrjen e tij, me faktin se ai ka ndjekur praktikën e tij sapo ka marrë detyrën, që rezultoi ta ketë marrë në fillim të 2020. Ne jemi këtu dhe kemi një vendim të KQZ-së që ka shkarkuar, i ka prerë mandatin kryebashkiakut socialist zotit Kajmaku, identik për të njëjtin rast. Një dënim të padeklaruar në Greqi, edhe ai për diçka të vogël, por pak rëndësi ka ajo. Rëndësi ka që nuk e kishte plotësuar formularin saktë sipas, jo vetëm ligjit të dekriminalizimit, por dhe sipas vendimit nr. 17 të Kuvendit, vendimit respektiv që plotëson ligjin e dekriminalizimit. Pra, vijimësia e institucioneve shtetërore, kërkon që praktika, jurisprudenca e KQZ-së nqs mund ta themi kështu, duhet të ndiqet njëkohësisht nga fillimi e deri më sot, për sa kohë nuk ka pasur ndryshime ligjore, ndryshime të tjera që cekin këto veprimtari. Pra, kemi rastin Kajmaku që vendimmarrja e zotit Celibashi bie komplet ndesh me vendimmarrjen e mëparshme. Nga ana tjetër, zoti Celibashi është justifikuar në vendimin e tij se ka ndjekur, të paktën kështu e ka thënë verbalisht në seancë dhe ne e kemi kërkuar për këtë shkak paraqitjen edhe të procesverbalit të seancës., zoti Celibashi ka thënë se ka ndjekur praktikën e ndjekur me zotin Zef Hila. Dakord! Kemi marrë vendimin përkatës për zotin Zef Hila, e kemi këtu, mund t'juja vemë në dispozicion, megjithëse është dhe në faqen e KQZ-së. vendimi nr. 338, datë 4.05.2021. "Për shqyrtimin e rezultatit të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

verifikimit të kandidatit..”, të asaj kohe. Po ta lexojmë vendimin është 16 faqe dhe rezulton se zoti Zef Hila nuk është dënuar asnjëherë. Ka pasur procese gjyqësore, patjetër, që kanë ndjekur të gjitha shkallët, shkallën e parë, apel, Gjykatë të Lartë, kthim për gjykim. Zotëria nuk është dënuar asnjëherë, as nga Gjykata e Shkallës së Parë, as nga apeli, as nga rigjykimet e mundshme që ka pasur. Pra, pse e themi këtë gjë?! Sepse rasti që zoti Celibashi ka ngritur për të justifikuar “precedentin” (në thonjza) të tij, nuk ka asnjë lidhje me rastin e zotit Kreshnik Hajdari. Pra, kemi këto dy elementë që duam t’i nënvizojmë me forcë, përpara trupës së KAS-it dhe që duhet që mbi bazën e këtyre por dhe mbi bazën e ligjit, vendimit nr. 17 të Kuvendit, duhet që KAS në vlerësimin tonë ta rrëzojë vendimmarrjen e zotit Celibashi dhe të vendosë atë që ne kemi kërkuar që në krye të herës. Pra, konstatimin e mbarimit të mandatit të zotit Hajdari për shkak të shkeljeve në deklarimin e formularit. Për këto arsye, kërkojmë pranimin e kërkesës sipas objektit të saj.

**Z. A. Llangozi, avokat (PL):** Për korrektesë në faqen 14 të procesverbalit të seancës së datës 14.11.2023, zoti Celibashi gënjen duke thënë se: KQZ-ja ka disa raste precedentë të kandidatëve për deputetë të Koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, zotit Zef Hila. Ashtu siç tha kolegu, por dhe në vendimmarrjen e këtij Komisioneri, nuk rezulton që zoti Zef Hila të ketë pas probleme që bien në kundërshtim si me ligjin, por dhe me vendimin e Kuvendit. Kjo sepse është miratimi nga Prokuroria e Përgjithshme, ose më saktë vendimi që ka sjellë që nuk ka konstatuar asnjë lloj problematike në lidhje me këtë subjekt zgjedhor. Pra, në mënyrë absurde, devijohet procesi me një precedent që nuk ka lidhje fare me precedentin. Për këtë arsye është një vendim me përmbajtje të rreme, e bërë me qëllim për favorizim. S’ka dashur kandidati, por unë do të bëj kallëzimin përkatës dhe për këtë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

shtetas, sepse ka shumë problematika qoftë në vendim, por qoftë dhe në funksionin e tij si i zgjedhur në këtë vend.

**Z. E. Lako:** Mirë faleminderit, në qoftë se në këtë moment të shqyrtimit të çështjes nga pala ankuese nuk ka ndonjë shpjegim tjetër, atëherë i japim fjalën...

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Kemi për të vënë në dispozicion dhe precedentin e ndjekur nga zotëria, procesverbalin e seancës të datës 14.11.2023 dhe vendimin e zotit Kajmaku që është identik si rasti i zotit Kreshnik Hajdari.

**Z. E. Lako:** Mirë faleminderit, atëherë fjala për ju zoti Sollaku!

**Z. Th. Sollaku, avokat (i kandidatit K. Hajdari):** Pala jonë mban qëndrimin që vendimi objekt ankimimi i Komisionerit është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi. Ne i qëndrojmë pretendimeve që kemi paraqitur edhe në seancën e Komisionerit, që pretendimi i paraqitur nga ankuesit për dënimin në shtetin grek, edhe në qoftë se do të jetë i vërtetë, nuk përbën shkak ndalues për të kandiduar apo për të mbajtur funksione publike. Është e vërtetë që ka disa vendime të kohëve të fundit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që merret me disa subjekte që kanë pasur detyrimin për të deklaruar në bazë të ligjit të dekriminalizimit. Por, Gjykata e Lartë nuk merr përsipër në asnjë rresht të vendimeve të saj, ajo nuk citon që “mosdeklarimi i veprave të tilla siç është kalimi i paligjshëm i kufirit, që pretendohet, të bëhet shkak ndalues”. Ky moment, pra mosdeklarimi në formular, mund të jetë objekt i procedurave të tjera, siç jemi tani në proces penal nga SPAK-u dhe presim se si do të përfundojë ai. Pra, përfundimisht do të thojë që vendimi i Komisionerit është i bazuar në fakte e në ligj dhe si i duhet të lihet në fuqi

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

**Z. E. Lako:** Mirë faleminderit zoti Sollaku! Do të kalojmë te pyetjet...

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Në lidhje me rastin që kolegu parashtroi që Gjykata e Lartë...

**Z. E. Lako:** Do të keni momentin tuaj për të bërë pyetje...

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Gjykata e Lartë ka thënë, po e lexoj “referuar përmbajtjes së formularit të vetëdeklarimit në bazë dhe në zbatim të ligjit 138/2015, i miratuar me vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, subjektet deklaruese të përcaktuar në këtë ligj, kanë detyrimin të pasqyrojnë në formular çdo dënim penal të formës së prerë dhënë nga një autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj, pavarësisht llojit të veprës penale dhe masës së dënimit të dhënë”. Këtë ka thënë Gjykata e Lartë, atëherë është detyrim, apo nuk është detyrim..., në qoftë se duam ta mbrojmë e ta mbulojmë, le ta lemë rastin.

**Z. Th. Sollaku, avokat (i kandidatit K. Hajdari):** Pasoja thotë gjykata, sjell mosdeklarim!

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Pasoja, pavlefshmëria.. aty te formulari, se po të jetë ashtu të gjithë po vijmë e gënjejmë para instuticionit. Gjykata thotë që secili kandidat duhet të pasqyrojë të dhëna të sakta. Në qoftë se do të frymëzohen që kandidatët vijnë këtu dhe sjellin të dhëna të pasakta, eja të vijmë këtu dhe...

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 5.01.2024*

**Z. E. Lako:** Në këtë pikë biem dakord besoj të gjithë, edhe pala e interesuar që të gjithë kandidatët duhet të pasqyrojnë të dhëna të sakta. Nuk besoj se ka ndonjë kundërshti këtu?! Kështu që të mos e bëjmë debat këtë pikë. Nga anëtarët e KAS-it ka ndonjë pyetje, si për palën ankuese, ashtu dhe për palën e interesuar? Po, zoti Rusmali!

**Z. I. Rusmali:** Në qoftë se unë e kam kuptuar drejt këtë kërkesën tuaj ankimore, ju kërkoni që të shpallet pavlefshmëria e mandatit, bazuar në një nga pikat e nenit 10, të ligjit për dekriminalizimin, apo jo?

**Z. A. Llangozi, avokat (PL):** Po!

**Z. I. Rusmali:** Pyetja që kam unë, neni 10 përcakton kompetencën. Shkakun ligjor e përcakton një nen tjetër. Mund të na bëni referencën te shkaku ligjor, te neni respektiv i këtij ligji të dekriminalizimit, për shpalljen e pavlefshmërisë së mandatit?

**Z. E. Lako:** Meqenëse jemi këtu, doja ta plotësoja dhe unë, se dhe unë këtu e kisha pyetjen time. Në lidhje me atë që pyeti zoti Rusmali, ka të bëjë pak a shumë dhe me nenin 2, të vendimit të Kuvendit, për shkeljet të cilat janë në kompetencë të organeve të KQZ-së. Pra, këtë që po shqyrtojmë sot, sepse gjatë fjalës tuaj, ju përmendët shumë herë pjesën “vepër penale”, po siç dhe ju e dini, ne nuk jemi këtu për të shqyrtuar që është kjo vepër penale. Kjo, sepse janë organe të tjera që merren me këtë punë. Për sa i përket kompetencës së KAS-it, në vijim të pyetjes që bëri zoti Rusmali, edhe unë këtu e kisha, ku e mbështesni? Mund të na e shpjegoni pak ju lutem këtë pjesë? Kompetencën e KAS-it në lidhje me këtë shkelje për të arritur qëllimin, sipas objektit të kërkesës tuaj, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Po! Kërkesën në lidhje me konstatimin e pavlefshmërisë.., se në thelb është pavlefshmëria e formularit të vetëdeklarimit. Pra, ku është problematika? Problematika qëndron te rrethana të rreme. Në seancën maratonë që ne kemi bërë me ankimin në lidhje me rastin kur ishin zgjedhjet, në lidhje me vendimin që ishte, ju kam parashtruar disa rrethana të cilat, pavlefshmëria është një veprim juridik i cili konstatohet nga instuticioni, qoftë edhe kryesisht. Ju mora si shembull, unë mund të vij me një prokurë, apo autorizim pa nënshkrimin e subjektit, ju atëherë do të konstatonit pavlefshmëri? Kjo sepse unë nuk është se kam sjellë autorizimin në formën e kërkuar. Formulari i vetëdeklarimit të zotit Hajdari është një formular i cili nuk është në formën e kërkuar, por edhe nëse ne i referohemi vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, ai i përcakton në mënyrë të qartë rastet kur duhet të konstatohet pavlefshmëria. Ne jemi më shumë te konstatimi i pavlefshmërisë së mandatit të zotit Hajdari, sipas vendimit 17/2016. Kjo konstatohet kryesisht nga ana e instuticioneve, sepse kemi të bëjmë me pavlefshmëri të një formulari vetëdeklarimi.

**Z. I. Rusmali:** Më fal se nuk e kuptova. Pra, referenca tani nuk është neni 10 i ligjit të dekriminalizimit?

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Jo është edhe neni 10, edhe.., janë të dyja.

**Z. I. Rusmali:** Unë dua të di lidhjen me nenin 10. Neni 10 shkaqet i ka te neni 2, ose 3 i ligjit. Për shkaqet e përcaktuara në nenin 2, ose 3 të ligjit (se nuk e mbaj mend tani), futet në veprim mekanizmi i pavlefshmërisë së mandatit. Në shkaqet e nenit

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

2, ose 3 (e gjejmë) keni ndonjë nga ato pikat që referohet si shkak ligjor për të futur në veprim mekanizmin?


**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** E kemi te neni 10, pika “ç”.

**Z. I. Rusmali:** Neni 10 është kompetenca, shkaqet ligjore janë në nenin 2.

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Po, neni 2 ka të bëjë me të drejtën e kandidatit për të kandiduar apo jo, jo për moszgjedhjen. Tani kandidati ka kandiduar, ka paraqitur të rrethana të rreme dhe jemi përpara nenit 10, pika “ç”, që duhet të konstatohet. Ku e ka ndalimin një institucion të konstatojë pavlefshmërinë e një formulari, apo të dhënave të rreme. Ju mund ta quani të ligjshëm, në qoftë se SPAK nesër arrin ta dënojë me vendim penal të formës së prerë, atëherë ku është vendimmarrja juaj? Ju duhet të merrni vendimmarrje të cilat nuk janë të frutshme, të pazbatueshme, me të dhëna të rreme? Në lidhje me pavlefshmërinë e mandatit jeni ju kompetentë, nuk është SPAK-u. SPAK-u merr vendim dënimi.

**Z. I. Rusmali:** Edhe një herë të lutem! Neni 10 thotë: “veprimet e organeve kompetente kur verifikohen kushtet e ndalimit”. Kushtet e ndalimit janë objekt i nenit 2. Që ne të mund të veprojmë sipas nenit 10 duhet të ndodhemi përpara kushteve të ndalimit. Cili nga kushtet e ndalimit që përcakton neni 2, përfshihet në rastin tuaj? Kjo është pyetja ime. Pastaj nëse ka arsyetim tjetër për shkaqe të tjera, për kushte të tjera, për analiza të tjera ligjore, e bëjmë më vonë, por fillimisht ezaurojmë ligjin e dekriminalizimit.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 5.01.2024*

**Z. F. Nuri, avokat (P L):** Në shtesë të argumentave të kolegut, lidhur me pyetjen tuaj, si bazë ligjore ne kemi përdorur edhe vendimin e Kuvendit. Saktësisht në Kreun 3, pika 3, germa “ç” e vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit ku thuhet se “Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota dhe të pasakta në të, passjell përjashtimin e menjëhershëm në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik..”. Ne jemi pikërisht në këtë rast. Jemi duke thënë që zotëria ka bërë deklaram të pasaktë dhe rrjedhimisht në zbatim të vendimit të Kuvendit i cili ka dalë në plotësim të ligjit të dekriminalizimit, duhet bërë përjashtimi i tij i menjëhershëm. Jo nga kandidimi, sepse ka kandiduar dhe është zgjedhur, por nga funksioni publik që është një nga katër rastet që ky ligj parashikon. Pra, po themi ligj në aspektin, edhe pse është vendim i Kuvendit por është i integruar tashmë dhe në jurisprudencën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndaj kemi marrë këtu dhe rastin e zotit Kajmaku. Ky debat ka ekzistuar edhe më parë në KQZ. Nuk është hera e parë që bëhet një diskutim i tillë. Kemi fiks rastin e zotit Kajmaku ku këto debate juridike janë bërë dhe në atë kohë, për të ditur nëse ishte ligji ai që duhej zbatuar, apo vendimi i Kuvendit. Shumica e KQZ-së në atë kohë doli me arsyetimin që dhe vendimi i Kuvendit është pjesë përbërëse e ligjit dhe nuk mund të shihet i shkëputur. Pra, ne i mëshojmë vendimit të Kuvendit. Formulari që kuvendi ka miratuar. Formulari i dekriminalizimit e ka specifikuar mjaft qartë që në rast se nuk përgjigjesh saktë rrezikon, jo vetëm për veprën penale, por edhe mandatin. E ka të parashikuar në pikën 3, germa “ç” vendimi i Kuvendit. “Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota dhe të pasakta, passjell përjashtimin e menjëhershëm nga funksioni publik..”, pa i cituar rastet e tjera, faleminderit!

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Këtë e keni në faqen 7 të saj është ky lloj arsyesimi.


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

**Z. I. Rusmali:** Në vijim të kësaj që tha zoti Nuri, në kërkesën tuaj ankimore, ju referoni, të paktën në një rast e ndesha unë, te shkaku ligjor “falsifikim i formularëve, etj., etj.”. Ka kryer veprën penale të falsifikimit të formularëve, apo jo?! Kjo që thoni tani është e ndryshme nga ajo që shkruhet., pra në efektin e vet juridik është e ndryshme? Pretendimi është që ka kryer veprën penale të falsifikimit të formularëve? Apo pretendimi është që ka bërë deklarime të rreme, të cilat vetëm për faktin që konstatohen nga ana juaj se janë të rreme, vënë në lëvizje mekanizmin e vendimit të Kuvendit.

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Ajo që ne kemi parashtruar që ky fakt përbën veprën penale është një indicie që ju në përfundim të kësaj vendimmarrje, keni detyrimin ligjor të bëni kallëzim, sipas nenit 281 të Kodit të Procedurës Penale. Pra, ky kallëzim duhet të ishte bërë me kohë, pavarësisht se u favorizua si u favorizua rasti deri në këto momente, që ne kemi marrë rrugën dhe kemi bërë një kallëzim penal. Kjo gjë ka qenë detyrë e organeve kompetente dhe juaja, që ju të ishit drejtuar prokurorisë. Në rastin aktual, ky është një udhëzim që ne ju bëjmë me dije që në bazë të nenit 281, të Kodit të Procedurës Penale, duhet të bëni kallëzim. Nëse ne i referohemi faktit që falsifikimi në vetvehte ka të bëjë dhe me pavlefshmëri, sepse një akt i falsifikuar, ka dhe pavlefshmëri. Një akt i falsifikuar nuk mund të jetë i vlefshëm. Referuar nenit 92, të Kodit Civil, ne kemi kërkuar që ky veprim i kryer nga zoti Hajdari është i pavlefshëm edhe në këndvështrim të kësaj dispozite ligjore. Pra, është një veprim që duhet të ishte konstatuar me kohë. Ju nuk e keni bërë dhe jemi në këtë fazë. Pra, kjo është lidhja që ne kemi thënë që kjo është veprën penale. Nuk e kemi kërkuar ne meqenëse kjo përbën veprën penale, ju jeni kompetentë të hetoni veprën penale. Jo s’jemi në këtë fazë. Sipas vendimit të Kuvendit, që ne e kemi parashtruar në faqen 7 të kërkesës tonë, me nr. 17/2016 është pasqyruar në

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*


mënyrë të qartë. Ju vetë duhet ta kishit konstatuar, KQZ-ja, sepse e thotë: “Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, të pasakta, passjell përjashtimin e menjëhershëm në çdo kohë”. Nuk thotë pasi të shtyhet dhe nja 10 vjet andej nga SPAK-u, apo të zvarritet procesi dhe eja të gjykojmë. Në çdo kohë, madje dhe koha aktualisht për mendimin tonë është e vonuar, sepse nuk ta thotë ligji, apo ky vendim që duhet të presim njëherë institucionin përkatës se çfarë vendimi do të marrë, por e ke në çdo kohë.

**Z. F. Nuri, avokat (P L):** Për më tepër që institucioni përkatës Prokuroria e Përgjithshme e mori përgjigjen zyrtarisht nga autoritetet greke. Ne e patëm paraqitur si koalicion që në prill vendimin të përkthyer, të noterizuar, me vulë apostile, vendimin ose më saktë vendimin e Gjykatës së Janinës, që vërtetonte dënimin e zotërisë në formë të prerë. Ajo nuk u muar për bazë në atë kohë pasi nuk mund të konstatonte kryesisht KQZ-ja. U kërkua në kanale zyrtare palës, pra po themi Prokurorisë së Përgjithshme që është e ngarkuar nga ligji për kryerjen e këtyre veprimeve. Përgjigjja e Prokurorisë erdhi dhe dokumenti është mjaft i qartë, ka ardhur në kanale dhe komunikime zyrtare nga pala greke nëpërmjet prokurorisë, thotë që zotëria është “I dënuar”. Pyetjes që: “ke qenë i dënuar apo jo?”, e vërteta është që duhet të ishte “po” dhe i depërtuar, “I dënuar dhe I depërtuar”.

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Po dhe i depërtuar në vitin 2017, gjë që nuk është...

**Z. I. Rusmali:** A mund t’ju ndërpres për një moment se po largoheni shumë, ndërkohë që pyetja ime ishte shumë e thjeshtë. Fjalja “falsifikim i dokumentave zyrtare”, ka kryer veprën penale të falsifikimit të dokumentave zyrtare, nuk ka lidhje me objektin e kërkesës. Me objektin e kërkesës, kështu po thoni apo jo, ka lidhje

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

vetëm fjalia që ka bërë deklaram të rremë dhe deklarimi i rremë sipas konstatimit tuaj, formon shkak për... Deklarimi i rremë është i ndryshëm nga falsifikimi i dokumentave zyrtarë. Po apo jo?!

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Po!

**Z. I. Rusmali:** Është i ndryshëm?

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** I ndryshëm!

**Z. I. Rusmali:** Dakord!


**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Nëse ne duhet ti japim kohë, le ti japim kohë, por do të bëjmë interpretime siç bën zoti Celibashi menjëherë, sepse nuk mundet ta keqinterpretojmë, dispozitën dhe pikërisht pika 3, germa “ç”, “Menjëherë..” thotë “..duhet të konstatohet”.

**Z. I. Rusmali:** Ka lidhje kjo me pyetjen time se nuk e kuptova? Të lutem pyetja ime ishte kemi dy koncepte juridike të ndryshme, apo kemi një koncept të njejtë në të dy formulimet. Kaq ishte pyetja ime. Ka lidhje me pyetjen time, që të mos hutohem unë?!

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Ne kemi kërkuar, në lidhje me falsifikimin...

**Z. I. Rusmali:** Të lutem, jo nuk dua se çfarë ke ti në mendje. Dua të sqaroj pyetjen time, pyetja ime është e qartë dhe përgjigjja të jetë e qartë. Janë deklarimi i rremë dhe falsifikimi i dokumentave zyrtarë janë dy gjëra të ndryshme, nuk janë e njejtë gjë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Po nuk janë e njejta gjë.

**Z. I. Rusmali:** Njëra është vepër penale, tjetra nuk është, apo jo?

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Po!


**Z. I. Rusmali:** Dhe ju nuk keni punë me veprën penale, nuk ju intereson në këtë proces, në procese të tjera ndoshta jo. Juve ju intereson vetëm deklarimi i rremë, i cili nuk është vepër penale. Kaq!

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Po!

**Z. E. Lako:** Po Zoti Bele!

**Z. K. Bele:** Më fal, e kisha më shumë për zotin Nuri se dëgjova atë komentin tuaj lidhur me kontenitetin e mbajtjes të qëndrimeve të njejta nga institucionet, në këtë rast duke ju referuar KAS-it. Besoj jeni familjar me rastin e zotit Qerim Ismailaj kryetar i Bashkisë së Mallakastrës, i cili është trajtuar në KAS dhe tani shoh që paska një vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative që ka konfirmuar të njejtin vendim. Nuk dimë, mund të ketë një vendim tjetër të mëvonshëm të apelit apo jo?! Nuk jam në dijeni të këtij fakti, por sjell në vëmendjen tuaj që në rastin e zotit Ismailaj vendimarrja e KQZ-së dhe KAS., ju sjell në kujtesë ky person ka qenë i dënuar në Greqi, i dënuar 6 muaj. Jo ishte rasti i dënimit i konfirmuar nga autoritetet shqipëtare, i njohur i tillë si shkak dënimi, me punë për interes publik. Është një

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

histori e gjatë dhe vendimi i mëparshëm i KAS-it. Ku e shihni diferencën midis këtyre rasteve? Nëse ka!

**Z. F. Nuri, avokat (P L):** Mund të përgjigjet dhe kolegu. Në respekt të pyetjes tuaj nuk jam në dijeni fare të rastit të zotit Qerim Ismailaj, sepse ishte i ngritur le të themi nga pjesa e Partisë Demokratike të përfaqësuar nga zoti Basha dhe nuk qenë fare prezent, nuk kam dijeni fare për atë çështje. Nuk e kam ndjekur personalisht, megjithatë, kolegu ka njohuri besoj në lidhje me ecurinë juridike të asaj çështje dhe mund të jetë më në gjendje t'i përgjigjet. Faleminderit!

**Z. K. Bele:** Jo nuk e kisha për çështje faktike kush është njëri, kush është tjetri. Ata janë zotërinj në punën e tyre. E kisha vetëm lidhur me, duke qenë se zoti Nuri pyeti, ose ju referua qëndrimeve të KAS-it lidhur me çështje të dekriminalizimit. Pavarësisht, se si anëtar i KAS-it unë kam mbajtur qëndrimin në pakicë më shumë se një herë, që KAS nuk është kompetent për të diskutuar këto çështje. Kjo nuk ka gjetur reflektim në vendimmarrjet e gjykatës, por kjo pak rëndësi ka.

**Z. F. Nuri, avokat (P L):** Vetëm një sqarim të vogël ju lutem te citimi im. Unë ju referova vijimësisë së institucionit të KQZ-së. Unë nuk u kapa me KAS-in në vetvehte. E kisha me KQZ-në, me vendimmarrjen e nëntorit të 2019 të KQZ-së, së drejtuar në atë kohë nga zoti Biba, pra e kisha si institucioni KQZ. Patjetër që KAS është pjesë e KQZ-së, por këtu e kisha më tepër. Nuk u mora me KAS në veçanti.

**Z. K. Bele:** E kuptova logjikën tuaj! Ju sjell në vemendje, pa dashur t'ju ndërpres, që përtej rastit të zotit Kajmaku, ka disa praktika të mëvonshme të cilat ndoshta nuk janë identike.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Në lidhje me rastin e zotit Ismailaj, mesa unë jam në dijeni, është një rast parazgjedhor dhe Kolegji Zgjedhor, apo në dijenin time gjykata e ka lënë me arsyetimin se partia politike nuk mund të përzgjedhë kandidatë. Kjo ka qenë ideja me të cilën unë jam njohur. Gjithesesi në lidhje me praktikën nuk mund të merret orientim një vendim i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë kur ne kemi një vendim të Kolegjit të Gjykatës së Lartë. Kur kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese që ja kemi vënë në dispozicion që është rasti i zotit Ismailaj, i zotit Kryetarit të Bashkisë së Kavajës, Elvis Roshi. Janë disa raste që dhe Gjykata Kushtetuese ka folur. Atëherë, pse duhet të marrim ne për bazë vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, që është një vendim i ankimeshëm, nuk është ndjekur, sepse ka qenë i qëllimshëm ky proces, janë të tjera gjëra. Në rastin aktual, ne duhet të marrim për bazë vendimet të cilat janë orientuese në mënyrë të drejtëpërdrejtë. As vendimi Apelit nuk është orientues për juve. Janë vendimet e Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese etj. Ne jemi përpara këtij rasti që Gjykata e Lartë ka një vendim, Gjykata Kushtetuese ka një vendim, kemi praktika të tjera të panumërta. Kështu që nuk mund t'i referohemi një praktike të zotit Celibashi, se çfarë ka në mend ai, apo si do ta interpretojë ligjin.

**Z. K. Bele:** E kuptova. Falemiderit!

**Z. Lefter Maliqi:** Shkurtimisht, i nderuar relator, të nderuar anëtarë të KAS-it, pa ju vonuar, pasi besoj se paraprakisht vendimi mund të jetë marrë. Unë jam këtu si palë meqë e kam votuar atë ligj dhe e zeza është mbi të bardhë dhe thotë shprehimisht “deklarim i rremë”, çfarëdolloj veprë penale të kesh kryer, automatikisht nuk mund të zgjidhesh, do të lesh mandatin, e të gjitha me rradhë që u cituan. Rasti i pyetjes


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

suaj për rastin e Ballshit, po unë kam marrë dijëni, siç kam marrë edhe për Zef Hilën. Rasti i Ballshit është një rast tjetër, ka nxjerrë arsyetimin që nuk ka pasur dijëni. Është dënuar në mungesë. Rasti Hajdari është rast tjetër, i Hajdarit të famshëm. Rast tjetër, i cili ka qenë prezent në sallën e gjyqit në prani të 18 shtetasve të tjerë dhe e ka këtë formular për herë të dytë, me dijëni të plotë, e ka plotësuar me deklaram të rremë dhe i depërtuar si drejtor KESH-i, sipas Prokurorisë së Përgjithshme nga Interpol Athina. Dhe ne këtu jemi për këto raste, që do të thotë rasti Kajmakut, institucionet tuaja e kanë nxjerrë, rasti i Roshit që vajti deri në Gjykatën Kushtetuese, rasti i Gled Rehovicës që vajti pastaj në Gjykatën Administrative, që përmendet për të njëjten gjë. Pra ne jemi këtu për këte gjë, e bardha mbi të zezë, deklaram i rremë. Kurse për problemet e tjera, e di shumë mirë, që në datën 10 Gjykata e Kastacionit, Prokuroria e SPAK-ut, Gjykata e Posaçme për Krimin e Organizuar ka gjyqin për zotin Hajdari, për falsifikim vulash, për këtë akuzë që ne i kemi bërë, në formular. Kjo nuk ka të bëjë fare, sepse ajo mund të shkojë në apel, mund të shkojë 2 vjet, 3 vjet në të gjitha shkallët. Për rastin që jemi te ju, jemi vetëm për këte problem, sepse unë si ish deputet mund të jem terrorist, kam bërë një vrasje jashtë shtetit dhe nuk e kam deklaruar aty. Ju me thoni mua “për këtë ligj pse ke deklaram të rremë”, ikni pastaj në SPAK e në organet e drejtësisë. KQZ-ja dhe KAS-i janë për këtë problem, për vendimin, ligjet e dekriminalizimit të votuara në mënyrë unanime nga parlamenti i Shqipërisë ashtu siç krijuan SPAK-un, ashtu edhe këtë ligj, për ta zbatuar. Nuk ka nevojë për komente të tepërta, çfarë keni vendosur vendoseni, sepse ne e dimë shumë mirë, që me keqardhje duhet ta them, që institucionet në këtë vend vazhdojnë të jenë të kapura, pa ju gjykuar ju në vendimin që do të merrni. Ju faleminderit!

**Z. E. Lako:** Zoti Maliqi, pa dashur që të ngremë ndaj njëri-tjetrit aludime apo... Ne prandaj po i bëjmë pyetjet që ta qartësojmë këtë çështje. Në lidhje me këtë që sapo

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*


thatë që “ju mund të keni bërë një vrasje”. Ato mund të hyjnë te sfera e atyre ndalimeve që përcakton vendimi i Kuvendit. Prandaj ne po merremi me kompetencën tonë dhe me rastet që hyjnë, apo nuk hyjnë në sferën të cilat ne shqyrtojmë. Prandaj dhe ne po i bëjme këto pyetje, nuk është se ne po i marrim apriori, apo e dimë se çfarë ka ndodhur apo ta parashikojmë se çfarë do të ndodhë.

**Z. Lefter Maliqi:** Ligji i Kuvendit e shpreh “deklarim i rremë”, nuk thotë fare për vepër penale dhe përveç kësaj vendimi Gjykatës së Lartë, vendimi i Gjykatës Kushtetuese për të njëjtat raste edhe më të lehta se këto, i ka lënë në fuqi. Tani zoti Celibashi...

**Z. E. Lako:** Përsa i përket vendimeve të gjykatave më të larta, ne kemi rënë dakord që në fillim që çdokush ka detyrimin të bëjë deklarime jo të rreme, deklarime të sakta.

**Z. Lefter Maliqi:** Mund të hapni audion, nuk e di a është e shkruar apo jo, zoti Celibashi tha, se filloi ngadalë e pastaj e ngriti zërin në fund. Ai tha që “Unë jam dakord që ky e ka thyer ligjin. Duhet ta plotësonte formularin të rregullt, por unë kam bërë një procedure tjetër, nuk mbaj përgjegjesi për kryetarët që kanë qenë para meje. Unë mbaj përgjegjësi për këto më pas. Unë kam pas një rast për Zef Hilën, të cilin e ankimoi Partia Socialiste, deputetët e tyre dhe e lashë, se nuk e kapte ligji i dekriminalizimit, e me rradhë”. Unë menjëherë ndërhyra pyeta se nuk e dija historinë e Zefit. Zefi as i dënuar, as i arrestuar, as brenda vendit, as jashtë vendit. Thjesht ka qenë i paditur siç paditet çdo zyrtar. Kaq!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

**Z. E. Lako:** Mirë faleminderit! Ka ndonjë pyetje nga anëtarë të tjerë të KAS-it për këtë çështje?

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Diçka që dua të sqaroj në lidhje me vendimmarrjen referuar dhe procesverbaleve. Zoti Celibashi tha se “subjektet nuk kanë detyrimin ligjor të deklarojnë ato vepra penale të cilat nuk janë detyrim sipas nenit 2, të ligjit të dekriminalizimit”. Është në procesverbal. Ndërkohë me vetëdije të plotë, ai u vu në dijeni të vendimit të Gjykatës së Lartë, që ne e kemi venë në dispozicion, njëkohësisht dhe me një sërë vendimesh të Gjykatës Kushtetuese. Pra ndryshe, ndoshta nuk e ka dëgjuar mirë kandidati, ka thënë shprehimisht..., referojuni dhe procesverbalit, nuk ka detyrim ligjor të deklarojë kur ndërkohë vendimi i Kuvendit e përcakton në mënyrë të qartë.

**Z. E. Lako:** Komisioneri ka shprehur qëndrimin e tij me vendim. Ju të gjitha argumentat që keni kundër atij vendimi i shprehët. Nëse nuk kemi ndonjë gjë tjetër në këtë fazë atëherë mund të kalojmë te konkluzionet përfundimtare. Shkurtimisht ju lutem, duke filluar nga ankuesi.

**Z. A. Llangozi, avokat (P L):** Pranimin e ankimit që ne kemi bërë pranë jush dhe kërkojmë shfuqizimin e vendimit të KQZ-së të datës..., sipas procesverbaleve të seancës dhe vendimit 14 nëntor 2023, ora 12:00, Për arsytet që ne parashtruam qoftë në kërkesën hyrëse, por edhe përpara jush, kemi të bëjmë me një vendim që është i kundraligjshëm. Vendimi nuk është bazuar qoftë në ligjin për dekriminalizimin por edhe në vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me nr. 17/2016. Njëkohësisht është në kundërshtim edhe me vendimin e Kolegjit të Gjykatës së Lartë, për të cilën ne kemi paraqitur në cilësinë e provës në këtë seancë. Rezulton që

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

zoti Hajdari ka bërë deklaram të rremë. Referuar vendimit me nr. 17/2016 kreu 3, pika 3, është e përcaktuar në mënyrë të qarë që kur konstatohen të dhëna të pavërteta në formularin e vetdeklarimit menjëherë institucioni përkatës qoftë KQZ dhe KAS, konstatojnë pavlefshmërinë e mandatit. Ne i qëndrojmë kësaj kërkesë dhe kërkojmë pranimin e saj.

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Llangozi! Ju mbani të njëjtin qëndrim?

**Z. F. Nuri, avokat (P L):** Po mbajmë të njëjtin qëndrim. I qëndrojmë kërkesës tonë.

**Z. E. Lako:** Atëherë zoti Sollaku përse i përket pretendimeve përfundimtare!

**Z. Th. Sollaku, avokat (z. K. Hajdari):** Ne kërkojmë lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit.

**Z. E. Lako:** Mirë faleminderit. Atëherë KAS do të tërhiqet për vendim. Rreth orës 12:00, 11:50 do t'ju njoftojmë për të shpallur vendimin. Faleminderit!

**Rifillon seanca**

**Ora, 11:56**

**Z. E. Lako:** Mirë atëherë, në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështje, në mbështetje të nenit 21, pika 1, shkronja “b” të ligjit 10019, datë 29.12.2008 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar KAS vendosi:

- Pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore nr. 95/1, datë 24.11.2023 të paraqitur nga subjekti Partia e Lirisë.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 5.01.2024*

- Shfuqizimin e vendimit nr. 816, datë 14.11.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin e vetdeklaruar zotin Kreshik Riza Hajdari, kryetar i Bashkisë Kuçovë”.
  - Kthimin e çështjes për shqyrtim te Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, duke lënë detyrë që të shqyrtojë faktin nëse, KQZ në trajtimin e kërkesës, ndodhet në kushtet e nenit 66, të Kodit të Procedurës Administrative.
  - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
  - Bazuar në pikën nr. 1, të nenit 145, të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve të shpalljes së tij sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 152, të Kodit Zgjedhor.
- Me kaq e deklarojmë të mbyllur seancën. Ju faleminderit!

**Vendimi nr. 01**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

